



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC**

---

Numri i lëndës: 2022:196686

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04854339

**PPP. nr. 17/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtari Astrit Gashi me bashkëpunëtorin profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “P...” SH.A, kundër debitorit I.H nga Gllogoci, lidhur me borxhin në shumën prej 730.81 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit Privat F.B P. nr... të datës 03.12.2018, jashtë seancës me datën 27.10.2023 e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET** pjesërisht i bazuar prapësimi i debitorit I.H nga Gllogoci.
- II. SHFUQIZOHET Pjesërisht** Urdhëri mbi lejimin e Përmbartimit P. nr... të datës 03.12.2018 për periudhën kohore nga data 31.01.2014 e gjer me datën 28.12.2016 për shumën prej 632.11 Euro.
- III. OBLIGOHET** debitori I.H nga Gllogoci që në emër të borxhit për mbeturina për periudhën kohore nga data 31.01.2017 e gjer me datën 30.10.2018 të ia paguaj shumën prej 98.70 Euro me kamatë ligjore në lartësi 8% në vit duke filluar nga pranimi i këtij vendimi gjer në pagesën definitive të detyrimit.

**A r s y e t i m**

Kreditori Kompania Rajonale e Mbeturinave “P...” SH.A, ka parashtruar propozimin për lejimin e përmbartimit kundër debitorit I.H, lidhur me pagesën e borxhit për mbeturina për periudhën kohore nga data 31.01.2014 deri me datën 30.10.2018 në shumë totale prej 730.81 Euro me kamatë ligjore prej 8% në vit si dhe shpenzimet e procedurës në afat prej 7 ditësh, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, regjistrimi, vlerësimi, sekuestrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogarinë e kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbartim të datës 23.11.2018.

Organi përmbartues me Urdhërin P. nr... të datës 03.12.2018 e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori ka parashtruar prapësimin me shkrim me arsyetimin se borxhi me të cilën ngarkohet sipas Nenit 360 të ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) **ka arritur parashkrimi**, andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj prapësimin në tërësi si të bazuar, dhe të anulohet urdhëri përmbartimorë.

Kreditori ne afatin e parashikuar ligjor ka e bërë përgjigje në prapësimin e debitorit me arsyetimin se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, pasi që debitori duke qenë plotësisht i vetëdijshëm që kreditori është kompani publike e cila merret me mbledhjen e mbeturinave me qëllim mirëmbajtjes së higjienës publike, e ka injoruar në tërësi shërbimin që i është kryer vazhdimisht. Urdhëri për përmbartim përfshinë periudhën prej datës 31.01.2014 deri me datën 30.10.2018 që përbënë një periudhë prej 4 vitesh për të cilat debitori asnjëherë nuk ka paguar këstin mujor që është një shumë simbolike, i njëjti ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe që urdhëri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, si gjykatë përmbartimore në zbatim të dispozitave ligjore konkretisht të Nenit 69 e 71 të LPP-së vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqet sikurse në Nenin 69 e 71 të LPP-së, sipas të cilave do të pengohej përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar, lidhur me atë ku ka kërkuar që të aprovohet i njëjti si i bazuar dhe të anulohet në tërësi si jo ligjor dhe i parregullt urdhëri përmbartimor me arsyetimin se propozimi për përmbartim nuk i përmban kushtet ligjore të kërkuara konform Nenit 38 par. 1 të LPP-së.

Sa i përket pretendimeve lidhur me parashkrim, gjykata të njëjtat pretendime i aprovoj pjesërisht si të bazuara, pasi që i tërë borxhi me të cilën ngarkohet debitori I.H nga Gllogoci për periudhën prej datës 01.04.2014 deri me datën 28.12.2016 është borxh i parashkruar konform Nenit 360 par. 1 të LND-së. Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore prej datës 31.01.2017 e gjer me datën 30.10.2018 gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, kjo referuar Nenit 360 par. 2 të LMD-së, ku parashihet që *“afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti fillon të rrjedh në fundin e atij viti”*, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin 2017 afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh me datën 01.01.2018 me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit prej një (1) viti konform Nenit 369 të LMD.

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar si në pikën III të dispozitivit, gjykata u referua në Nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata konform Nenit 17 të LPP-së përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë dhe konform dispozitave të Nenit 3, 17, 29 par. 1.2 dhe 1.3 dhe par. 3, 35, 68. 71 e 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimorë, lidhur me Nenin 360 par.

1 dhe 2 dhe 368, 369 dhe 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc-  
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 17/2020, datë 27.10.2023**

**Gj y q t a r i**

**Astrit Gashi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.